

L PAY
LITY
WORLDWIDE
APPRECIATION
EQU
HUMAN

BARAZIA GJINORE



NËPËRMJET VETËQEVERISJES
LOKALE PARTICIPUESE

GJENDJET DHE SFIDAT



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN



Boton: Shoqata Forumi i Gruas - Tetovë

Për botuesin: Xhane Kreshova, drejtoreshë ekzekutive

Autor: Afërdita Haxhijahja Imeri

Përkthim dhe lektorim: Mursel Murseli

Kjo analizë u mundësua me mbështetjen e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për zhvillim ndërkombëtar (USAID) në kuadër të Projektit për pjesëmarrje qytetarëve. Përmbytja është përgjegjësi e Shoqatës Forumi i Gruas - Tetovë (FG) dhe nuk shpreh pikëpamjet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

CIP – Katalogizim në publikim

Biblioteka nacionale dhe universitare "Sh. Klimenti i Ohrit", Shkup

305.5:352(497.751)(047)

HAXHIJAHJA Imeri, Afërdita

Barazia gjinore nëpërmjet vetëqeverisjes lokale partcipuese : gjendjet dhe sfidat / [autor Afërdita Haxhijahja Imeri ; përkthim Mursel Murseli]. - Tetovë : Shoqata forumi i gruas, 2019. - 49 faqe. : ilustr. ; 20 cm

Fusnota ndaj tekstit. - Përmban: Shtojca

ISBN 978-608-65902-5-3

a) Родова еднаквост - Локална самоуправа - Тетово - Истражувања

COBISS.MK-ID 110138122

**BARAZIA GJINORE
NËPËRMJET VETËQEVERISJES
LOKALE PARTICIPUESE
GJENDJET DHE SFIDAT**

Dhjetor 2018



Përmbajtja

Mbi organiziatën dhe projektin.....	1
Hyrje.....	3
Konceptet dhe terminet ekzistuese	5
Qëllimet e analizës	7
Qasje metodologjike	8
Çështje kërkimore	9
Demografia e mostrës.....	10
Konstatimet e anketës	13
Qytetarët ndaj komunës	13
Komuna ndaj qytetarëve	21
Konstatime të fokus grupeve	26
Format e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve.....	26
Mekanizmat ekzistues për interakcion me qytetarët.....	28
Pjesëmarrje e publikut në përgatitjen e dokumenteve operative dhe strategjike	29
Kycja e publikut nëpërmjet komisioneve të Këshillit dhe koordinatorët	30
Kycje e perspektivës gjinore në bashkëpunim dhe interaksion me qytetarët	32
Mënyrat e informimit të qytetarëve	32
Rekomandime kyçe	35
Shtojca - Informata të dobishme	38

Mbi organiziatën dhe projektin

Forumi i Gruas - Tetovë (FG) është shoqatë joqeveritare, jopartiake, jofitimprurëse dhe humanitare, e themeluar në Janar të vitit 2001 në Tetovë. FG selinë e ka në Tetovë, por aktivitetet e saj i realizon në rajonin më të gjerë të pjesës perëndimore e veriore të Maqedonisë. FG numëron rreth 40 anëtarë të kyçur në mënyrë aktive në aktivitetet e organizatës.



Drejtoresha ekzekutive e Shoqatës Forumi i Gruas, përfaqësues nga Fondacioni Metmaorfozis dhe ekspertja e angazhuar për hulumtimin, në një nga ngjarjet në kuadër të projektit

Vizioni i Forumit të Gruas - Tetovë është t'i trajtojë gratë si të vetëdijshme, të çliruara nga normat dhe paragjykimet tradicionale e patriarkale ekonomisht të fuqizuara dhe të barabarta në gjini dhe të integruara në shoqëri. Vizioni i hartuar do të arrihet nëpërmjet punës me gra të ndryshme, sidomos me gra të mjediseve rurale, duke i inkurajuar e ndihmuar, duke i mbështetur në fuqizimin e tyre nëpërmjet informimit, edukimit dhe përfaqësimit të të drejtave, nevojave dhe interesave të tyre.

Në vitin 2018 organizata e filloi realizimin e projektit "Përmirësimi i zërit të qytetarëve, veçanërisht zërit të grave në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal". Projekti ka si qëllim të rris nivelin e ndërgjegjshmërisë së qytetarëve, sidomos të grave, për të drejtat e tyre si dhe për nevojën e pjesëmarrjes së tyre gjatë miratimit të vendimeve të pushtetit lokal. Në këtë mënyrë do të arrihet një menaxhim dhe zhvillim më i mirë i bashkësisë.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është:

- Rritja e vetëdijes së qytetarëve, sidomos të grave, për të drejtat e tyre dhe nevojën e demokracisë participative, me qëllim të sigurimit të menaxhimit dhe zhvillimit më të mirë të bashkësisë.

Qëllimet specifike të projektit janë:

- Fuqizimi i rolit të anëtarëve në shoqëri, veçanërisht rolit të gratë, për të folur për çështje të rëndësishme për shoqërinë dhe për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse në nivel lokal;
- Të fuqizohet besimi i ndërsjellë dhe bashkëpunimi ndërmjet vetëqeverisjes lokale dhe qytetarëve;
- Nxitja e qytetarëve për t'u bërë pjesë e vetëqeverisjes lokale dhe politikave të saj.

Granti i realizuar nga Shoqata Forumi i Gruas - Tetovë është mbështetur nga ana e projektit të USAID për pjesëmarrje qytetare, kurse kjo analizë është pjesë e këtij granti.

Hyrje

Parimi themelor i demokracisë është kyçja dhe pjesëmarrja e grave dhe burrave në krijimin e politikave dhe realizimit të tyre. Rëndësia e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e krijimit të politikave është theksuar në shumë dokumente ndërkombëtare, kurse në Republikën e Maqedonisë janë miratuar një sërë ligjesh për pjesëmarrjen e grave dhe burrave në këtë proces. Si më të rëndësishëm janë Ligji për vetëqeverisje lokale, Ligji për mundësi të barabarta të grave dhe burrave, kodi zgjedhor si dhe më shumë dokumente strategjike që thirren në kyçjen e qytetarëve dhe pjesëmarrjen e tyre aktive në zhvillimin dhe realizimin e politikave dhe qëllimeve përkatëse strategjike.



Trajnime të mbajtura për ngritjen e kapaciteteve të përfaqësuesve të bashkësive lokale në rajonin e Tetovës

Në kontestin e planifikimit dhe zhvillimit të vetëqeverisjes lokale, pjesëmarrja e publikut është pasqyrim i idealeve demokratike. Në këtë mënyrë nxitet besimi i publikut në legjitimitetin dhe përgjegjësinë e pushtetit, njëherit e rritë transparencën në sistemin rregullues të tij. Me fjalë të tjera, atëherë kur publikut i krijohet mundësia të merr pjesë në pushtetin lokal përfitimet janë të mëdha.

Përskaaj këtyre përfitimeve, praktikuesit, shoqëria civile dhe qytetare ende nuk e kanë gjetur modelin funksional, sipas të cilit do të promovoheshin dhe përparonin marrëdhëniet ndërmjet popullatës lokale dhe institucioneve që ndikojnë në jetën e tyre. Por, nga ana tjetër edhe në kuadër të mekanizmave ekzistues, pjesëmarrja e qytetarëve si mundësi për të ndikuar ndaj politikave lokale dhe miratimit të vendimeve nuk është shfrytëzuar sa duhet në mënyrë efikase apo funksionale. Ashtu siç hulumtuesit dhe praktikuesit dëshmojnë deri më sot, përpjekjet e pjesëmarrjes qytetare janë sporadike dhe kryesisht të inicuar nga bashkësia ndërkombëtare dhe/apo organizata qytetare dhe jo nga pushtetet lokale.

Edhe pse në Maqedoni nuk u realizua hulumtimi gjithëpërfshirës kushtuar kësaj teme, dëshmitë ekzistuese sugjerojnë për mungesën e përkushtimit, resurseve dhe lidhshimit në mesin e pushteteve lokale për promovimin dhe fuqizimin e pjesëmarrjes së qytetarëve. Dëshmitë më tej sugjerojnë se kyçja dhe pjesëmarrja e pushtetit lokal nuk është tërheqës për qytetarët dhe sidomos nuk është tërheqës për gratë.

Aftësia për t'i bindur qytetarët për të pasur besim tek funksionarët e zgjedhur lokal është parakushti kryesor për krijimin e proceseve të qëndrueshme të reformave demokratike. Sa më e fuqishme të jetë lidhja ndërmjet këtyre dy palëve (qytetarëve dhe funksionarëve të zgjedhur), aq më e suksesshme dhe më demokratike do të jetë shoqëria e cila do të zhvillohet.

Pa dyshim kjo marrëdhënie proporcionale fuqizohet me përgatitjen e funksionarëve të zgjedhur që t'i përgjigjet nevojave reale të qytetarëve, të punojnë për interesin më të mirë qytetarë dhe t'ia përmirësojnë cilësinë e jetës. Kjo sidomos është e rëndësishme në nivelin e vetëqeverisjes lokale ku kjo marrëdhënie është më e qartë, e prekshme dhe e ndijshme.

Konceptet dhe terminet ekzistuese

Individët dhe grupet që janë të kyçur në procesin e vendimmarrjes trajtohen si palë të involvuara. Miratimi i politikave lokale është në interesin e tyre, sepse ato politika ndikojnë në mirëqenie, jetesë dhe përditshmërinë e qytetarëve.

Pjesëmarrja e publikut definohet si qasje e qytetarëve, drejtpërdrejtë apo tërthorazi në proceset e zhvillimit të politikave apo të ofritit të shërbimeve të pushtetit, me qëllim të informimit më të mirë, kyçjes në miratimin e vendimeve si dhe ndryshimin e modeleve të krijuara të fuqisë.



Fushatë rrugore me qëllim informim të qytetarëve për demokracinë participative e mbajtur në qendër të qytetit të Tetovës

Kur bëhet fjalë për modelet e kyçjes së publikut si dhe profili i qytetarëve për ato, ekzistojnë disa drejtime teorike që mund të rangohen në tre më kryesor:

Modeli elitistik¹ sipas të cilit vetëm qytetarët e informuar mirë siç janë profesionistët, praktikuesit, politikanët dhe akademikët mund të ofrojnë kontribut thelbësor nëpërmjet kyçjes në punë të pushtetit lokal. Fatkeqësisht ky model nuk e njeh kontributin e të ashtuquajturve anëtarë të shoqërisë.

Përfitime individuale² është modeli i dytë sipas të cilit edhe pse jo të gjithë anëtarët e bashkësisë janë të informuar mirë, vizionet dhe rekomandimet e tyre janë njësoj të dobishme, por për të arritur të artikulohen nevojitet edukim i vazhdueshëm si dhe ndërgjegjësim i qytetarëve për rolin dhe përgjegjshmëritë e vetëqeverisjes lokale.

Jo më pak i rëndësishëm është modeli i tretë që fokusohet në nivelet e pjesëmarrjes së publikut³, sipas të cilit ka dallim ndërmjet vetëdijes publike, pra krijimit të vetëdijes qytetare, involvimit të publikut dhe pjesëmarrje e publikut. Sipas këtij modeli vetëdija publike nënkupton shpërndarje njëkahëse e informacionit nga pushteti lokal tek qytetarët. Involvimi i publikut arrihet gjatë shpërndarjes dykahëse të informatave nga qytetarët tek pushteti lokal dhe anasjelltas. Pjesëmarrja e publikut, për dallim nga dy proceset paraprake, nënkupton kyçjen e qytetarëve nëpërmjet ndarjes demokratike të përgjegjësisë ndërmjet pushtetit dhe qytetarëve.

Nga kjo që u tha më lartë mund të konkludojmë se miratimi i vendimeve duhet të ndodhë në proces gjithëpërfshirës me të gjithë palët e involvuara. Në këtë proces, qytetarët e informuar mirë janë themeli i shoqërisë të mbështetur në dituri që është argument shtesë për nevojën e edukimit dhe ndërgjegjësimit të vazhdueshëm të qytetarëve, me qëllim të fuqizimit të kapaciteteve të tyre për transparencë, llogaridhënie dhe gjithëpërfshirje në proceset e miratimit të vendimeve në pushtetin lokal.


¹ Brown, 1990

² Torgerson 1986

³ Evan Vlachos , 1993

Qëllimet e analizës

Analiza ka më shumë qëllime nga të cilët dy të poshtë shënuarit mund të ndahen si më të rëndësishëm.



Qasje metodologjike

Rezultatet e analizës bazohen në kombinimin e këtyre metodave hulumtuese:

Anketë me banorët e komunave të rajonit të Tetovës, pra të komunës së Bogovinës, komunës së Bërvenicës, komunës së Tetovës, komunës së Tearcës, komunës së Jegunovcës dhe komunës së Zhelinës. Anketa është zhvilluar nga dera në derë (çdo derë e katërt nga ana e djathtë në komunat urbane dhe çdo derë e tretë nga ana e djathtë në komunat rurale) me 700 të anketuar.

Anketa është realizuar nga ana e 7 (shtatë) anketueseve, duke e shfrytëzuar pyetësorin e përpiluar paraprakisht në gjuhën shqipe dhe maqedonase, për shkak të përbërjes etnike të banorëve të komunës. Që të gjithë 7 (shtatë) anketueset së bashku me pëfqësuese të Forumit të Gruas iu nënshtruan trajnimit paraprak që kishte për qëllim të nivelizojë qasjen e anketueseve gjatë realizimit të anketës, t'i sqarojë dilemat lidhur me çështje të caktuara dhe gjithashtu trajnimi të kontribuojë edhe në edukimin e vetë anketuesve në lidhje me pjesëmarrjen e publikut duke i përfshirë edhe gratë në punën e vetëqeverisjes lokale.

Grupet e fokusit me përfaqësues të administratës komunale në vetëqeverisjet lokale të rajonit të Tetovës. Gjithsej janë mbajtur 6 grupe fokusi pra në secilën komunë nga një grup fokusi me gjithsej 38 pjesëmarës. Për nevojat e fokus grupeve ishte përpiluar pyetësor i veçantë i cili ka ndihmuar në hulumtimin e qëndrimeve, përvojave dhe njohjen e obligimeve të administratës në lidhje me pjesëmarrjen e publikut në punën e komunës.

Çështje kërkimore

Pyetja e përgjithshme të cilës hulumtimi ka tentuar t'i jep përgjigje është: A e kyçin publikun në punën e tyre vetqeverisjet lokale të rajonit të Tetovës?

Disa aspekte të komunës janë hulumtuar në kuadër të kësaj çështjeje kërkimore:


- Format dhe mjetet e informimit;
- Problemet më të shpeshta për të cilat i drejtohen komunës;
- Niveli i njohurive dhe përdorimi i mundësive ligjore për pjesëmarrjen e qytetarëve;
- Kyçje në planifikimin e dokumenteve strategjike, operative apo buxhetore;
- Sa besojnë në shfrytëzueshmërinë e kyçjes së qytetarëve;

Në lidhje me fokus grupet hulumtimi do të tentojë:


- Të bëjë matjen e përvojës së administratës në realizimin e formave të ndryshëm të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve, të paraparë me ligj;
- T'i evidentojë mekanizmat ligjor nëpërmjet të cilëve sigurohet pjesëmarrje e qytetarëve;
- Të bëjë matjen e pjesëmarrjes së publikut gjatë përgatitjes së dokumenteve operative apo strategjike të komunës;
- Të matet niveli i pjesëmarrjes së publikut në punën e komisioneve të Këshillit dhe niveli i kyçjes së perspektivës gjinore;
- Të matet funksionaliteti dhe llojet (nëse ekzistojnë) i mekanizmave të komunës për informimin e publikut.

Demografia e mostrës


Të dhënat në rajonin e Tetovës bazohen tek mostra e 700 personave të anketuar nga të cilët 519 apo 74% janë gra dhe 181 apo 26% janë burra.



Mosha e të anketuarve është nga 18 deri 71 vjeçare, ku 41% janë të moshës nga 18 deri 34 vjeçare, 269 apo 38% janë të moshës nga 35 deri 50 vjeçare, 134 apo 19 % janë të moshës nga 51 deri 70, dhe 1% e të anketuarve të moshës 71 e më tepër vjeçare.




Nga ata 450 apo 64% janë Shqiptar/e, 228 apo 33 % janë Maqedonas/e, kurse 2 % janë Turq dhe 1% të tjerë.



Përkatësia etnike

Struktura arsimore e mostrës është si në vijim: Me arsimim 8 vjeçar 166 apo 24 %, 304 apo 43% të të anketuarve kanë të kryer shkollimin e mesëm, 230 apo 33% kanë të kryer arsimim të lartë.



Sa i përket punësimit të anketuarit janë deklaruar si në vijim:

Përgjigje	Numri	%
Me orar pune të plotë	260	37,1%
Me orar pune të shkurtuar	34	4,9%
Të papunësuar	110	15,7%
Amvise	146	20,9%
Student, nxënës	90	12,9%
Pensionist	43	6,1%
Tjetër	17	2,4%

Punësimi i të anketuarve

Në tabelën e mësipërme numri më i madh i të anketuarve, respektivisht 260 janë deklaruar si të punësuar me orar të plotë pune, kurse 110 të papunësuar. Përqindje relativisht e lartë prej 21% janë amvise që punojnë në shtëpi.

Sa u përket grupeve të fokusit, gjithsej janë përfshirë 38 të anketuar nga 6 vetqeverisje lokale të përfshira.

Në grupet e fokusit morrën pjesë përfaqësues të Sektorit të arsimit, zhvillimit ekonomik lokal, marrëdhënie me publikun, koordinator të mundësive të barabarta si dhe këshilltar të Këshillit të komunës.

Konstatimet e anketës


Parakusht themelor për pjesëmarrje në proceset e planifikimit lokal dhe marrjes së vendimeve është që banorët të kenë njohuri mbi rolin, funksionin, përgjegjësitë dhe obligimet e vetëqeverisjes lokale. Në të shumtën e rasteve banorët e komunës nuk e kanë të qartë ndarjen e përgjegjësisë ndërmjet pushtetit qendror dhe atij lokal, prandaj që këtu dalin pritjet e qytetarëve për pushtetin lokal të cilat nuk janë reale sepse ato janë jashtë përgjegjësisë të vetëqeverisjes lokale.

Qytetarët ndaj komunës


Në pyetjen se për çka është përgjegjëse komuna 77% e të anketuarve janë përgjigjur pozitivisht, kurse diçka më pak se një e treta nuk kanë njohuri për ingerencat e pushtetit lokal. Kjo përqindje është tepër e lartë dhe këtu bëjnë pjesë banorët e territoreve rurale (111) të anketuar, gra (132) të rinjë nga mosha 18-34 vjeçare (72) me përkatësi etnike shqiptare (102).

Një profili të këtillë të banorëve komunat duhet t'i orientojnë aktivitetet në rafshin e marrëdhënieve me publikun me qëllim të edukimit dhe informimit të tyre dhe krahas kësaj edhe rritje e vetëdijes dhe gatishmërisë për përfshirje në punën e vetëqeverisjes lokale.


A e dini çfarë përgjegjësi ka komuna?



A informoheni për punën e komunës?



Qytetarët/et nuk informohen për punën e vetëqeverisjes lokale, 59% e të anketuarve janë përgjigjur pozitivisht, kurse 41% e përgjigjeve janë negative, për shkak të pa interesimit (31%) nuk kanë nevojë nga një informim i tillë (11%) apo se nuk janë të informuar me që vet komuna nuk i informon (11%). Nga të anketuarit që informohen, pjesa më e madhe (30%) tek informatat arrijnë nëpërmjet bisedave me miq, medimeve tradicionale si TV dhe radio (25%) dhe nëpërmjet fejsbuk të komunës (15%).



Në çfarë mënyre informoheni për punën e komunës?

Format më të shpeshta të shfrytëzuara janë *Facebook* dhe radio e televizioni, sepse lehtë mund të arrihet, kurse më pakë të shfrytëzuara janë gazetatat sepse nuk i blejnë dhe tek të anketuarit më të moshuar aplikimi në fejsbuk të cilin nuk e shfrytëzojnë.

Kur bëhet fjalë për paraqitjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve tek vetëqeverisja lokale për një kërkesë konkrete dhe/ose pyetje 48% janë deklaruar pozitivisht, i janë drejtuar, kurse 52% nuk i janë drejtuar.

Analiza detale dëshmon se nuk ka dallim sa i përket kësaj çështjeje ndërmjet popullatës urbane dhe rurale, por ku e njëjta çështje do të krahasohet me gjininë, rezulton se 55% e grave janë përgjigjur me jo dhe 55% e meshkujve janë përgjigjur me përgjigje pozitive që do të thotë i drejtohen komunës me kërkesa dhe pyetje konkrete.

Gjithashtu persona me arsimim tetë vjeçarë të kryer janë përgjigjur me përgjigje negative 64% për dallim nga ata me arsimim të mesëm e sipëror të cilët rreth 51% i drejtohen komunës.

Vendbanimi	Po	%	Jo	%
Mjedisi urban	100	48%	110	52%
Mjedisi rural	234	48%	256	52%
Seksi	Po	%	Jo	%
Femra	234	45%	285	55%
Meshkuj	100	55%	81	45%
Niveli i arsimimit	Po	%	Jo	%
Arsimimi tetë vjeçar	60	36%	106	64%
Arsimimi i mesëm	157	52%	147	48%
Arsimimi sipëror	117	51%	113	49%

A jeni drejtuar ndonjë here deri te komuna?

Fatkeqësisht një numër i madh i të anketuarve nuk kanë besim në mekanizmat ekzistues për përfshirjen e qytetarëve dhe se nëpërmjet tyre mund të arrihet ndonjë ndryshim pozitiv. Nga ata që megjithatë besojnë në përfshirje, deklarojnë se ajo duhet të jetë më gjithëpërfshirëse.

Gjithashtu jo më pak e rëndësishme, në rastet e rralla të përfshirjes, kërkohet barabarësi dhe barazi në respektimin e zërit të tyre, pa dallim të statusit social.

Kjo do të thotë se vetëqeverisjet lokale nuk janë të hapura sa duhet për grupet më të cënuara të qytetarëve dhe qytetareve të cilët për shkak të statusit prekës të tyre është supozuar se kanë nevojë për mbështetje më të madhe pikërisht nga komuna.

Këto kategori të qytetarëve dhe problemet me të cilat ballafaqohen, kurse në rrafshin e vetëqeverisjes lokale i lënë të pazgjidhura apo kërkojnë mënyra alternative të zgjidhjes së tyre nëpërmjet shfrytëzimit të kapitalit të tyre social (miq e të njohur) ose mbështetje nga familja.

Përgjigje	366	100%
Nuk kam pasur ndonjë problem/nevojë deri tani	115	31,4%
Vetë/ në mënyrë vetiake	95	26,0%
Asesi/nuk i zgjidh/nuk di	76	20,8%
Të tjerët e zgjidhin familja/miq të	41	11,2%
Me lidhje familjare/miqësore	13	3,6%
Në mënyra të tjera	20	5,5%
Duke iu drejtuar bashkësisë lokale	3	0,8%
I pyes qytetarët	3	0,8%


Si i zgjidhni problemet?

Megjithatë qytetarët që i drejtohen komunës, pjesa më e madhe e tyre (32 %) këtë veprim e bëjnë për shërbime komunale dhe në masë të vogël për çështje lidhur me urbanizmin (27%) dhe mjedis jetësor (14%).

Përgjigje	Numër	%
Urbanizëm	91	27,2%
Mjedis jetësor	49	14,7%
Zhvillim ekonomik	14	4,2%
Shërbime komunale	107	32,0%
<i>furnizimi me ujë (ujësjellës)</i>	32	29,9%
<i>kullim i ujrave të mbetura (kanalizim)</i>	15	14,0%
<i>grumbullim dhe depozitim të mbetjeve</i>	13	12,1%
<i>transport publik</i>	8	7,5%
<i>pastërti publike</i>	14	13,1%
<i>parqe e gjelbërime</i>	1	0,9%
<i>ndriçim publik</i>	17	15,9%
<i>hapësirë parkimi</i>	7	6,5%
Kulturë	8	2,4%
Sport e rekreim	4	1,2%
Mbrojtje sociale dhe mbrojtje të fëmijëve	6	1,8%
Arsimim	23	6,9%
Mbrojtje shëndetësore	14	4,2%
Kërkesë mbështetjeje për dëmet nga fatkeqësitë natyrore	7	2,1%
Tjetër	11	3,3%
<i>Kërkesë për punë</i>	10	90,9%
<i>Uzurpim të sipërfaqeve publike</i>	1	9,1%

Për çfarë problem jeni drejtuar te komuna?

Është interesante të analizohet edhe mënyra e të drejtuarit dhe komunikimit të qytetarëve tek vetëqeverisja lokale.




Mënyra e drejtimit dhe komunikimit e qytetarëve deri te vetëqeverisja lokale

Vërehet se paraqitja gojarisht shfrytëzohet në masë shumë më të madhe, nëpërmjet mbledhjeve dhe me telefon se sa paraqitja me shkresë/dokument i shkruar. Edhe pse komunikimi gojor është i drejtpërdrejtë dhe më efikas, hulumtimet⁴ dëshmojnë se ky lloj komunikimi nuk rekomandohet kur bëhet fjalë për administratën apo në masë më të vogël, komunikimi gojor duhet të shoqërohet edhe me paraqitje me shkrim. Komunikimi me shkrim mundëson të kërkohet reagimi kthyes dhe me këtë edhe llogaridhënie dhe përgjegjësi nga ana e shërbimeve të administratës.

⁴ www.referenceforbusiness.com/small/Sm-Z/Written-Communication.html

Fatkeqësisht praktika në Maqedoni konfirmon se përskaaj komunikimit me shkrim dhe gojor, administrata komunale nuk është efikase⁵ e as efektive, prandaj për të pasur informatë kthyesë dhe reagim në kërkesat e qytetarëve, pa marrë parasysh formën e kërkuar, duhet të ketë vullnet politik. Vetëm në këtë mënyrë do të nxiteshin reformat në sistemin e vlerave të administratës ku në qendër të vëmendjes do të ishte qytetari.

Për të arritur tek zyrtari përgjegjës për çështje të caktuar, qytetarët duhet të bëjnë përpjekje plotësuese për të identifikuar identitetin dhe vendndodhjen e administratorit, ashtu që u parashtojnë pyetje miqve apo i drejtohen vet komunës për të pyetur e për të marë udhëzime.




⁵ www.researchgate.net/publication/304065654_An_Overview_of_the_Reformed_Local_Government_in_Macedonia

Nga kjo rezulton se në komunë nuk ka informacion për qasje të lehtë të qytetarëve e që dëshmon se ku dhe tek cili duhet të drejtohen qytetarët. Për të ndriçuar problemin dhe për të kërkuar ndihmë, qytetarët duhet të humbasin kohë shtesë duke ulur shpresat se problemi do të zgjidhet.

Komuna ndaj qytetarëve

Kur bëhet fjalë për aktivitetet që i realizon vetëqeverisja lokale lidhur me përfshirjen e qytetarëve, situatat janë si në vijim:




A keni mare pjesë ndonjëherë në ndonjë formë të pjesëmarrjes qytetare?

Përqindja më e lartë e qytetarëve janë kyçur për të kërkuar takim me kryetarin/kryetaren e komunës në ditën e caktuar për pranim apo nëpërmjet mbledhjes me qytetarë.

Ajo që duhet thënë se që të dyja format nuk e obligojnë komunën apo kryetarin/kryetaren për mënyrën e veprimit. Komponent e rëndësishme e menaxhimit me vetëqeverisjen lokale është planifikimi i dokumenteve zhvillimore si dhe buxhetet periodike dhe vjetore.

Nga përgjigjet e marra rezulton se vetëqeverisjet lokale, objekt të kësaj analize minimalisht i kyçin qytetarët në procesin e planifikimit edhe pse korniza ligjore i obligon këtë ta bëjnë mbi bazë të rregullt.


Vetëm 90 të anketuar (nga gjithsej 700) kanë pasur mundësi të marrin pjesë në ndonjë proces të planifikimit lokal edhe atë së paku në miratimin e planeve urbanistike dhe programin vjetor të punës.



A keni mare pjesë ndonjëherë në përgatitjen e ndonjë dokumenti të komunës?

Megjithatë siç u theksua më parë, qytetarët nuk besojnë se pjesëmarrja e tyre do të kontribuoj në përmirësimin e punës së komunës dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve të caktuara, për të cilat ka përgjegjësi vetëqeverisja lokale.

Këshu, në pyetjen se a besojnë që pjesëmarrja e tyre i ka përmirësuar gjërat, madje 66% janë përgjigjur negativisht përballë 34% që kanë dhënë përgjigje pozitive.



A mendoni se pjesëmarrja juaj ka bërë ndryshim dhe i ka përmirësuar punët?

Një vit pas zgjedhjeve lokale⁶, përqindja më e madhe e qytetarëve nëpër komuna të rajonit të Tetovës janë deri diku të kënaqur (43%) dhe (31%) janë të pakënaqur.

Përgjigje	Број	%
Shumë i/e kënaqur	44	6,3%
I/e kënaqur	137	19,6%
Deri diku jam i/e kënaqur	301	43,0%
Fare nuk jam i/e kënaqur	218	31,1%

Sa jeni të kënaqur nga puna e komunës, në fakt shërbimet të cilat vetëqeverisja lokale ua jep qytetarëve?

Megjithatë, pa marrë parasysh pakënaqësinë, qytetarët vlerësojnë se nëse do ketë vullnet politik dhe përkushtim puna e administratës lokale dukshëm do të mund të përmirësohej nëpërmjet informimit më të mirë dhe përparimit të bashkëpunimit/kyçjes së qytetarëve.

Madje 60% e të anketuarve besojnë në këtë mundësi që është potencial i madh dhe pikë solide e nisjes për përmirësimin e gjërave, duke pasur parasysh pesimizmin dhe jobesueshmërinë e shprehur më lartë.

Përgjigje	Numri	%
Po	424	60,6%
Jo	276	39,4%

A mendoni se puna e komunës dhe shërbimet që komuna i ofron mund të përmirësohen nëpërmjet përfshirjes së qytetarëve?

⁶ Zgjedhjet lokale për kryetarë dhe këshilltar të komunës janë mbajtur në Tetorë të vitit 2017.

Në këtë mundësi më pak besim ka popullata rurale (64%), gratë (62%), banor të përkatësisë etnike shqiptare (62%) dhe ata me arsimim sipëror (64%).

Vendbanimi	Po	%	Jo	%
Mjedisi urban	109	52%	101	48%
Mjedisi rural	315	64%	175	36%
Seksi	Po	%	Jo	%
Femërore	321	62%	198	38%
Mashkullore	103	57%	78	43%
Mosha	Po	%	Jo	%
18-34	183	64%	105	36%
35-50	160	59%	109	41%
51-70	75	56%	59	44%
71+	5	56%	4	44%
Përkatësia nacionale	Po	%	Jo	%
Maqedonas	132	58%	96	42%
Shqiptarë	277	62%	173	38%
Serb	1	33%	2	66%
Turq	10	63%	6	37%
Romë	2	100%	0	0%
Vllehë	0	0%	0	0%
Të tjerë	1	100%	0	0%
Niveli i arsimimit	Po	%	Jo	%
Arsimim tetëvjeçar	95	57%	71	43%
Arsimim i mesëm	182	60%	122	40%
Arsimim sipëror	147	64%	83	36%

Konstatime të fokus grupeve

Format e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve

Kur bëhet fjalë mbi përvojat dhe praktikën e vetëqeverisjeve lokale në rajonin e Tetovës për organizimin dhe realizimin e formave të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve të parapara me Ligjin e vetëqeverisjes lokale⁷. Nga të dhënat e shënuara në tabelën e mëposhtme mund të konstatohet se administrata komunale ka një përvojë dhe praktikë minimale për realizimin e formave të parapara.

Madje edhe aty ku realizohen, sipas informatave të ndara, mund të konkludohet se komuna nuk ka përpiluar e as publikuar formular të nevojshëm që do të mund të shfrytëzoheshin për realizimin e formave të sipërpërmendura të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve.



⁷ Iniciativa qytetare, referendumi, tubimi i qytetarëve, propozime dhe ankesa, tribina dhe anketa, shqyrtim publik dhe inspektim publik, forumi buxhetor.

Është fjala edhe pse komuna e Tetovës vërteton që ka organizuar propozime dhe ankesa, në pyetjen se a ka përpiluar e publikuar formular për propozime dhe ankesa, nuk është dhënë përgjigje pozitive.

Kyçja e publikut në përgatitjen e	Bogovinë	Bërvenicë	Jegunovcë	Tearcë	Tetovë	Zhelinë
Iniciativa qytetare						
Referendumi						
Tubimi i qytetarëve						
Propozime dhe ankesa						
Tribina dhe anketa						
Shqyrtim publik dhe inspektim publik						
Forumi buxhetor						

Mekanizmat ekzistues për interakcion me qytetarët

Sa i përket mekanizmave të interaksionit me qytetarë gjendja është si vijon:

<u>Kyçja e publikut në përgatitjen e</u>	Bogovinë	Bërvenicë	Jegunovcë	Tearcë	Tetovë	Zhelinë
Ditët e pranimit tek kryetar	😊	😊	😊	😊	😊	😊
Koordinatori për bashkësi urbane / rurale	😊	😊	😊	😞	😊	😞
Kontakte të shpallura të kryetarëve të U/R	😞	😊	😞	😞	😞	😞
Qendra për informimin e qytetarëve	😊	😞	😞	😊	😊	😊
Interaksioni i shpallur për mbledhjen e Këshillit	😊	😊	?	😞	?	😞

Informacionet e prezantuara na fokus grupet konfirmojnë se komunat janë më të hapura për interaksion me qytetarët në këtë pjesë. Ndërkaq të gjithë kryetarët e komunave kanë caktuar ditë për pranimin e qytetarëve, në komunën e Jegunovcës dhe komunën e Tearcës është shënuar se kryetari i pranon çdo ditë qytetarët. Nga njëra anë kjo është pozitive sepse në atë mënyrë realizohet kontakti i drejtpërdrejtë kryetar-qytetarë, por nga ana tjetër kjo mënyrë e punës të perceptohet nga ana e qytetarëve, se nuk është e mjaftueshme vetëm t'i drejtohesh administratës por për të gjitha sfidat

përfshihet edhe kryetari. Në këtë mënyrë i gjithë autoriteti orientohet kah njëri pozicion, në vend të administratës e cila ka obligime për ato çështje.

Është me interes të nënvizohet fakti që përkundër obligimit ligjor mbledhjet e Këshillit të jenë publike, 4 komuna nuk e shpallin rendin e ditës të mbledhjes së Këshillit e as informatën se kur do të zhvillohet ajo.

Pjesëmarrje e publikut në përgatitjen e dokumenteve operative dhe strategjike

Kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen e publikut në përgatitjen e dokumenteve operative dhe strategjike të komunës, gjendjet janë si në vijim:

<u>Kyçja e publikut në përgatitjen e</u>	Bogovinë	Bërvenicë	Jegunovcë	Tearcë	Tetovë	Zhelinë
Strategjia						
Programi vjetor i punës						
Buxheti vjetor						
Planet urbanistike						
Plani lokal aksional ekologjik						
Plani aksional për zhvillim ekonomik lokal						

Debatet e fokus grupeve dëshmojnë se pjesëmarrja e publikut më së shumti ndodhë gjatë përgatitjes së buxheteve vjetore dhe gjatë miratimit apo ndryshimit të planeve urbanistike. Kjo më pak ndodh gjatë përgatitjes së strategjive zhvillimore të komunës dhe më së paku gjatë përgatitjes së planit lokal ekologjik.

Gjithashtu mund të vërehet se administrata komunale nuk është e njoftuar me domosdoshmërinë dhe obligimin ligjor për kyçjen e publikut në përgatitjen e dokumenteve operative dhe strategjike të vetëqeverisjes lokale. Bie fjala, përfaqësuesit e vetëqeverisjes lokale të komunës së Jegunovcës nuk dinin të pohojë nëse publiku ka qenë i kyçur apo jo. Edhe më brengosës është fakti se vetëqeverisja lokale e komunës së Tetovës si më e madhe në rajonin e Tetovës, nuk kishte njohuri të përgjigjet në katër nga gjithsej gjashtë baza për kyçjen e publikut në përpilimin e dokumenteve operative dhe strategjike.

Prej këtu rezulton se informimi dhe edukimi janë aq të nevojshëm edhe për administratën dhe udhëheqjen e saj për nevojën e realizimit të obligimit ligjor për krijimin e kushteve dhe për përfshirjen e publikut në punën e komunës.

Kyçja e publikut nëpërmjet komisioneve të Këshillit dhe koordinatorët

Komisionet e Këshillit të komunës nëpërmjet këshilltarëve të zgjedhur paraqesin mekanizëm të drejtpërdrejtë për kyçjen e publikut. Edhe pse në pjesën më të madhe në komisione anëtarë janë këshilltarët në disa prej komisioneve ka anëtarë dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Jo më pak mekanizëm i rëndësishëm për kyçjen e publikut janë edhe koordinatorët në kuadër të administratës komunale. Vend të veçantë kanë koordinatori i mundësive të barabarta si dhe koordinatori/personi i emëruar për bashkëpunim me shoqërinë civile.

Gjendjet për këto mekanizma janë:

<u>Komisionet e Këshillit të komunës</u>	Bogovinë	Bërvenicë	Jegunovcë	Tearcë	Tetovë	Zhelinë
Koordinatori i emëruar për mundësi të barabarta	😊	😊	😊	😊	😊	😊
Koordinatori i emëruar për bashkëpunim me shoqërinë civile	😞	😞	😊	😞	?	😊
Komisioni për mundësi të barabarta	😊	😊	😊	😊	😊	😊
Komisioni për marrëdhënie ndërmjet bashkësive	?	😞	😊	😊	😊	😊
Këshilli për mbrojtjen e konsumatorëve	😊	😞	?	?	?	😞

Mund të konstatohet se situatat në lidhje me këtë mekanizëm për kyçjen e publikut janë diçka më të mira nga ato paraprake, por duhet pasur parasysh se vetëqeverisjet lokale kanë obligim ligjor për emërimin dhe funksionimin e mekanizmave të sipërpërmendur (me përjashtim të koordinorit për bashkëpunim me shoqërinë civile).

Kyçje e perspektivës gjinore në bashkëpunim dhe interaksion me qytetarët

Kur bëhet fjalë për kyçjen e perspektivës gjinore në bashkëpunim dhe interaksion me qytetarët në punën e vetëqeverisjes lokale, siç po shihet më lartë të gjitha komunat kanë emëruar koordinator të mundësive të barabarta si dhe komision për mundësi të barabarta.

Ndëkaq, nga ana tjetër asnjëra komunë nuk ka dokument të shkruar në formë të udhëzimit apo rekomandimit për kyçjen e të dy gjinive në ndodhi apo forma të tjera të kyçjes së qytetarëve.

Gjithashtu gjatë organizimit të mbledhjeve me bashkësitë lokale/rurale, si njëra nga format e drejtpërdrejta më të shfrytëzuara për kyçjen e publikut, në mbledhje para së gjithash merr pjesë popullata mashkullore, sepse komunat nuk zhvillojnë ngjarje plotësuese për t'i ftuar edhe gratë, respektivisht të organizojnë mbledhje në ato lokalitete që vizitohen më së shumti nga gratë.

Mënyrat e informimit të qytetarëve

Në kuadër të debatit të fokus grupeve janë shqyrtuar edhe mënyrat që i shfrytëzon vetëqeverisja lokale për informimin e qytetarëve. Në kuptimin më të ngushtë të fjalës informimi nuk nënkupton edhe kyçje të qytetarëve.

Nga ana tjetër mund të supozohet se informimi paraqet parakusht për kyçje, prandaj edhe e prezantuar këtë mekanizëm.

Komunat e analizuara i shfrytëzojnë këto mjete dhe kanale për informimin e qytetarëve:

Mënyra e informimit	Bogovinë	Bërvenicë	Jegunovcë	Tearcë	Tetovë	Zhelinë
Zëdhënësi/ja e komunës						
Tabela shpallëse e komunës						
Faqja e internetit e komunës						
Fletorja zyrtare e komunës						
Informatori komunal						
Qendra për informimin e qytetarëve						
Profili në fejsbuk i komunës						
Profili në fejsbuk i kryetarit						

Nga kjo që u tha më lartë mund të konkludohet se komunat shfrytëzojnë mjete të ndryshme për informimin e qytetarëve lidhur me aktivitetet që i ndërmarrin apo për kompetencat që i realizojnë.

Në qoftë se krahasohen të dhënat nga ana e qytetarëve për mënyrën e informimit të tyre me mjetet që vetëqeverisja lokale i shfrytëzon për t'i informuar qytetarët, mund të shihet se rrejetet sociale si fejsbuku, është mjet të cilin e shfrytëzojnë të gjitha komunat, gjithashtu edhe numri më i madh i qytetarëve.

Kjo sidomos ka të bëjë me qytetarët e moshave të reja. Për dallim prej tyre qytetarët më të moshuar më së shumti i shfrytëzojnë mjetet konvencionale të informimit, siç janë radio dhe televizioni, prandaj supozojmë se informatat që i ndanë komuna nuk arrijnë tek këta qytetarë.



Rekomandime kyçe

Mekanizmat ekzistues për kyçe të drejtpërdrejtë të qytetarëve në vetëqeverisjen lokale ashtu siç janë paraparë në ligjin për vetëqeverisje lokale, nuk janë shfrytëzuar për shumë shkaqe, nga të cilat më të rëndësishme janë:

- ✓ Mekanizmat nuk janë sa duhet të qartë, ashtu siç janë paraparë në Ligjin për vetëqeverisje lokale, si për qytetarët ashtu edhe për administratën e vetëqeverisje lokale;
- ✓ Administrata e vetëqeverisjes lokale nuk ka bërë përpjekje plotësuese për të lehtësuar zbatimin e mekanizmave të paraparë nga ana e qytetarëve ashtu që do të krijonte udhëzime plotësuese me kahje dhe hapa të qartë se si ato mekanizma mund të shfrytëzohen më lehtë;
- ✓ Për të iniciuar ndonjërin nga mekanizmat e nënvizuar (iniciativa qytetare, referendum, tubime të qytetarëve), nevojiten resurse njerëzore dhe financiare të cilat jo gjithmonë janë në dispozicion në anën e qytetarëve.

Për tu tejkaluar sfidat e lartëshënuara rekomandohet:

- ✓ Fuqizimi i kapaciteteve të administratës komunale dhe ndërgjegjësimi i tyre për dobinë e organizimit të formave të lartshënuara të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në punën e komunës;
- ✓ Administrata të përpilojë udhëzime dhe formular më të detajuar që do t'i shfrytëzonin qytetarët në rast të organizimit të formave të sipërpërmendura të pjesëmarrjes;
- ✓ Qytetarët të kenë qasje të lehtë e të pranueshme tek informatat e nevojshme si dhe të dhëna me qëllim të zbatimit efikas dhe efektiv të formave të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë.

Qytetarët nuk informohen për punën e vetëqeverisjes lokale, prandaj komuna duhet të gjej mënyra inovative për shpërndarjen e informacioneve si dhe kanale interaktive të komunikimit. Është për tu përshëndetur shfrytëzimi gjithnjë e më i madh i rrjeteve sociale, siç është fejsbuku, por ky kanal i komunikimit duhet të plotësohet edhe me mënyra të tjera që do të orientoreshin kah popullata më e moshuar e cila nuk i shfrytëzon rrjetet sociale apo nuk mundet/nuk ka kohë t'i shfrytëzojë ato.

Nisur nga kjo një numër i madh i qytetarëve informohen nëpërmjet medimeve tradicionale (TV, Radio) komuna do të mundet ta fuqizojë bashkëpunimin me qendra lokale të TV apo me radio stacionet.

Në përpjekjet e saja të limituara për kyçjen e publikut, vetëqeverisja lokale duhet të bëjë përpjekje plotësuese (përveç atyre ekzistuese) për kyçjen edhe të kategorive të cënuara të qytetarëve. Ata kanë nivle të larta të mosbesimit në vetëqeverisjen lokale, por nga ana tjetër kanë më shumë nevojë për mbështetjen nga vetëqeverisja lokale me qëllim të realizimit të të drejtave të caktuara apo shfrytëzimit të shërbimeve të deleguara.

Qytetarët si dhe administrata komunale duhet të insistojnë në komunikim formal/me shkrim përkaj praktikës ekzistuese të komunikimit verbal dhe interaksionit. Komunikimi me shkrim mundëson të kërkohej reaksion kthyes dhe me këtë edhe llogaridhënie dhe përgjegjësi nga ana e shërbimeve të administratës.

Komunat duhet t'i shtojnë përpjekjet ekzistuese për transparencë dhe llogaridhënie nga njëra anë, kurse qytetarët të insistojnë tek informacioni më i lehtë për të gjitha aspektet e punës së komunës si për atë se kush është përgjegjës për çështjet konkrete (kujt mund t'i drejtohen) ashtu edhe lidhur me dokumentet strategjike, operative dhe financiare.

Vetëqeverisjet lokale nuk bëjnë përpjekje plotësuese për kyçje të barabartë të burrave dhe grave në punën e komunës si dhe në aktivitetet që realizohen për këshillimin apo informimin e qytetarëve.

Përkaj emërimit të koordinatorit për mundësi të barabarta dhe funksionim të komisionit për mundësi të barabarta pranë Këshillit, mënyra tjetër e zbatimit të perspektivës gjinore në format tjera të kyçjes, nuk ekziston. Rekomandohet udhëheqësia dhe administrata ta përfshijnë perspektivën gjinore në të gjitha format e kyçjes së qytetarëve.

Diç më pak se një vjet pas zgjedhjeve lokale një numër i madh i qytetarëve shprehin pakënaqësi nga puna e vetëqeverisjes lokale, por, madje 60% besojnë se gjërat mund të ndryshohen. Pushtetet lokale do të duhej ta shfrytëzojnë këtë moment dhe të bëjnë një kthesë të nevojshme për më të mirën gjatë 3 vjetëve të mbetura të këtij mandati.

Shtojca – Informata të dobishme

KOMUNA E BËRVENICËS

Kryetar	Enver Pajaziti
Ueb faqja e komunës	www.brvenica.gov.mk
Ditë pranimi te kryetari	E enjte
Nevoja për domosdoshmëri të caktimit të takimit	Po
Personi përgjegjës për komunikim me bashkësitë urbane dhe rurale	Natasha Stojçeska
Kryetari i këshillit të komunës	Micko Kostadinovski
Personi përgjegjës për caktimin e pranisë në mbledhjet e Këshillit të komunës	Zimbile Demiri Natasha Stojçeska
Personi përgjegjës i qendrës për informim të qytetarëve	Saudi Zenuni
Faqja e FB e komunës	Nuk ka
Faqja e FB e kryetarit	www.facebook.com/EnverPajazitiPerKryetar
Koordinatori i mundësive të barabarta	Natasha Stojçeska
Koordinatori për bashkëpunim me shoqërinë civile	Nuk ka

KOMUNA E BOGOVINËS

Kryetar	Albon Xhemaili
Ueb faqja e komunës	komunabogovine.gov.mk
Ditë pranimi te kryetari	E premtë
Nevoja për domosdoshmëri të caktimit të takimit	Po
Personi përgjegjës për komunikim me bashkësitë urbane dhe rurale	Nehat Aliu Besir Miftari
Kryetari i këshillit të komunës	Jetmire Ramadani
Personi përgjegjës për caktimin e pranisë në mbledhjet e Këshillit të komunës	Hirijete Kurtishi
Personi përgjegjës i qendrës për informim të qytetarëve	Shpend Tairi
Faqja e FB e komunës	www.facebook.com/pages/Bogovinje-Municipality/207282165981886
Faqja e FB e kryetarit	www.facebook.com/albonxhemaili.mk/
Koordinatori i mundësive të barabarta	Ikmet Selmani
Koordinatori për bashkëpunim me shoqërinë civile	Shpend Tairi

KOMUNA E JEGUNOVČËS

Kryetar	Darko Bllazhevski
Ueb faqaja e komunës	http://opstinajegunovce.gov.mk
Ditë pranimi te kryetari	Çdo ditë
Nevoja për domosdoshmëri të caktimit të takimit	Po
Personi përgjegjës për komunikim me bashkësitë urbane dhe rurale	Vojkan Antoski
Kryetari i këshillit të komunës	Orhan Sabrii
Personi përgjegjës për caktimin e pranisë në mbledhjet e Këshillit të komunës	Mileva Mlladenovska
Personi përgjegjës i qendrës për informim të qytetarëve	Stojançe Antovski
Faqja e FB e komunës	https://www.facebook.com/opstina.jegunovce
Faqaj e FB e kryetarit	https://www.facebook.com/zivotvojegunovce/
Koordinatori i mundësive të barabarta	Mileva Mlladenoska
Koordinatori për bashkëpunim me shoqërinë civile	Vojkan Antoski

KOMUNA E TEARCËS

Kryetar	Isen Asani
Ueb faqja e komunës	www.Tearce.gov.mk
Ditë pranimi te kryetari	Çdo ditë
Nevoja për domosdoshmëri të caktimit të takimit	Po
Personi përgjegjës për komunikim me bashkësitë urbane dhe rurale	Merita Elmazi
Kryetari i këshillit të komunës	Fexhri Selmani
Personi përgjegjës për caktimin e pranisë në mbledhjet e Këshillit të komunës .	Gajur Salihi, Merita Elmazi
Personi përgjegjës i qendrës për informim të qytetarëve	Fitore Vejseli
Faqja e FB e komunës	https://www.facebook.com/Komuna-e-Tearc%C3%ABs-506113712762025/
Faqja e FB e kryetarit	https://www.facebook.com/isen.asani
Koordinatori i mundësive të barabarta	Merita Elmazi
Koordinatori për bashkëpunim me shoqërinë civile	Fatmire Alii

KOMUNA E TETOVËS

Kryetar	Teuta Arifi
Ueb faqja e komunës	www.tetova.gov.mk
Ditë pranimi te kryetari	E enjte
Nevoja për domosdoshmëri të caktimit të takimit	Po
Personi përgjegjës për komunikim me bashkësitë urbane dhe rurale	Flora Idrizi
Kryetari i këshillit të komunës	Bekim Memeti
Personi përgjegjës për caktimin e pranisë në mbledhjet e Këshillit të komunës	Emin Islami
Personi përgjegjës i qendrës për informim të qytetarëve	Armend Fazliu
Faqja e FB e komunës	https://www.facebook.com/komunaofficial/
Faqja e FB e kryetarit	https://www.facebook.com/teutaarifiofficial/
Koordinatori i mundësive të barabarta	Radmilla Angjellkovska
Koordinatori për bashkëpunim me shoqërinë civile	Zana Ademi

KOMUNA E ZHELINËS

Kryetar	Blerim Sejdiu
Ueb faqaja e komunës	www.zhelina.gov.mk/
Ditë pranimi te kryetari	E enjte
Nevoja për domosdoshmëri të caktimit të takimit	Po
Personi përgjegjës për komunikim me bashkësitë urbane dhe rurale	Mefail Osmani
Kryetari i këshillit të komunës	Liridon Useini
Personi përgjegjës për caktimin e pranisë në mbledhjet e Këshillit të komunës .	Agron Limani
Personi përgjegjës i qendrës për informim të qytetarëve	Shaban Limani
Faqja e FB e komunës	https://www.facebook.com/Komuna-E-Zhelin%C3%ABs-124461217576912/
Faqja e FB e kryetarit	https://www.facebook.com/Zhelina.Municipality/
Koordinatori i mundësive të barabarta	Zamira Zejnullai
Personi përgjegjës i qendrës për informim të qytetarëve	Shaban Limani

PYETËSOR ANKETUES PËR QYTETARËT E KOMUNAVE NË RAJONIN E TETOVËS

Prezentim

Prezentohu në mënyrën në vijim: "Mirë mengjes / dita / mbrëma, unë quhem _____ dhe punoj për "Forum e Gruas" organizatë joqeveritare e cila meret me ngritjen e vetëdijes të grave, për pavarësimin e tyre, dhe integrimin e grave në shoqëri. Momentalisht realizojmë hulumtim për pjesëmarrjen e qytetarëve me theks të veçantë gratë në proceset e sjelljes së vendimeve në komunat e rajonit të Tetovës (Tetovë, Jegunocë, Tearcë, Bogovinë, Bërvenicë dhe Zhelinë).

Përgjigjet për hulumtimin janë repretisist (konfidenciale) të besuara në përputhje me standardet e hulumtimit.

A. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

1.Vendi i banimit _____

2.Komuna : _____

B. DEMOGRAFIA

3. Gjinia

a) Femërore b) Mashkullore

4. Mosha _____ vite

5. Përkatësia etnike (VETËM NJË PËRGJIGJE)

a) Maqedone b) Shqiptare c) Serbe ç) Turke d) Rome dh) Vllehe

6. Arsimitimi (VETËM NJË PËRGJIGJE)

a) Elementare b) Arsim i mesëm / gjimnaz c) Arsim i lartë, magjistraturë, doktorat

7. Statusi i punësimit (VETËM NJË PËRGJIGJE)

a) I punësuar me orar të plotë të punës b) I punësuar me orar të shkurtuar të punës
c) I pa punësuar, tepriçë teknologjike, punëtor i falimentimit ç) Amvise
d) Student, nxënës dh) Pensioner
e) Tjetër, (shkruani) _____

8. Të ardhurat mesatare, mujore në familje (VETËM NJË PËRGJIGJE)

a) Më pak se 3.000 denarë b) 3.001 - 6.000 denarë c) 6.001 - 9.000 denarë
ç) 9.001 - 12.000 denarë dh) 15.001 - 18.000 denarë e) 18.001 - 21.000 denarë
f) 21.001 - 24.000 denarë g) 24.001 - 27.000 denarë h) 27.001 - 30.000 denarë
i) 30.001 - 45.000 denarë j) 45.001 + denarë k) Refuzon të përgjigjet

B. NDËRVEPRIMI ME KOMUNËN

9. A e dini se ku ndodhet ndërtesa e komunës (ku punojnë administratat e komunës)?

- a) Po b) Jo

10. A e dini se për cilat pyetje është përgjegjëse Vetëqeverisja lokale ?

- a) Po b) Jo

11. A informoheni për punën e komunës ?

- a) Po b) Jo

11.1 Nëse jo, pse nuk informoheni ? Përkruani _____

11.2 Nëse po, në cilën mënyrë vini deri te informatat ? (shënoni të gjitha që keni përdorur)

- | | |
|---|---|
| a) Nga bisedat me shokë /qe, të njohur, familjarë | b) Nga mjetet për informim publik (radio dhe TV) |
| c) Nga gazetat (nacionale, lokale) | ç) Nga informatat të vendosura në tabelën e komunës |
| d) Nga internet faqja e komunës | dh) Kam marrë pjesë në seancë të këshillit të komunës |
| e) Nga gazeta zyrtare e komunës | f) Nga informatori i komunës |
| g) Nga qendra për informim të qytetarëve | h) Nga facebook profili i komunës |
| i) Nga facebook profili i kryetarit / res | j) Tjetër (përkruani) |

11.2.1 Cilën nga format e lartpërmendurave e përdorni më shumë? Pse? _____

11.2.2 Cilën nga format e lartpërmendurave e përdorni më pak? Pse? _____

12. A keni adresuar ndonjëherë pyetje / problem në komunë?

- a) Po b) Jo

12.1 Nëse jo, si i zgjidhni problemet (në kompetencën e vetëqeverisjes lokale)? Përkruani _____

12.2 Nëse po, në cilën lëmi ?

- | | | |
|-----------------------------|---|---|
| a) Urbanizëm | b) Ambient jetësorë | c) Zhvillim ekonomik |
| ç) Aktivitetet lokale | | |
| Furnizimi me ujë | Depozitimi i ujërave të zeza (kanalizimi) | Mbledhjen dhe asgjësimin e mbeturinave |
| Transporti publik | Pastërtia publike | Parqet dhe gjelbërimi |
| Ndriçimi publik | Vend parkimi | |
| d) Kulturë | dh) Sport dhe rekreacion | e) Mbrojtje sociale dhe mbrojtje të fëmijëve |
| f) Arsim | g) Mbrojtje shëndetësore | h) Kërkesë për dëmet nga fatkeqësitë natyrore |
| i) Tjetër (përkruani) _____ | | |

13. Në çfarë mënyre do të drejtoheni deri te komuna ?

- | | |
|--|------------------------|
| a) Kam lënë termin deri te personi përgjegjës (për problemin tim/pyetje) | b) Kam dorëzuar letër, |
| c) Jam paraqitur në telefon | ç) Tjetër (përkruani) |

14. Si e dini se te kush duhet të drejtoheni ?

- a) Pyes shokë / të njohur dhe ato më udhëzojnë b) Shkoj në komunë dhe aty pyes të më udhëzojnë c) Tjetër (përshkruani)

15. A keni marrë pjesë ndonjëherë në ndonjë nga format e mëposhtme të pjesëmarrjes qytetare? (të rrethohen të gjitha në të cilat është marrë pjesë)

- a) Ditët e pranimit te kryetari b) Iniciativa qytetare c) Mbledhja e qytetarëve ç) Referendum
d) Paraqitja e përfaqësimeve dhe propozimeve dh) Tribina publike dhe anketa e) Shqyrtim publik dhe debat publik

16. A keni marrë pjesë ndonjëherë (nëpërmjet pjesëmarrjes të debatit publik, komenteve etj) në përgaditjen e ndonjë dokumenti të komunës ?

- a) Strategji / plani strategjik i komunës b) Programi vjetor c) Buxheti vjetor
ç) Planet urbanistike d) Plani lokal i veprimit mjedisor dh) Plani aksional lokal për zhvillim ekonomik
e) Plani aksional për mundësi të barabarta f) Tjetër (përshkruani) _____

17. A mendoni se pjesëmarrja juaj ka bërë një ndryshim dhe ka përmirësuar gjërat?

- a) Po b) Jo

17.1 Nëse po, sqaroni si _____

17.2 Nëse jo, çka duhet të ndryshohet ? _____

18. Sa jeni të kënaqur nga puna e komunës në fakt shërbimet të cilat vetëqeverisja lokale ua jep qytetarëve?

- a) Shumë jam i / e kënaqur b) I / E kënaqur
c) Deri diku jam i / e kënaqur ç) Nuk jam i / e kënaqur

19. A mendoni se puna e komunës dhe shërbimet që ajo ofron mund të përmirësohen përmes përfshirjes më të madhe të qytetarëve?

- a) Po b) Jo

19.1 Përderisa po, çfarë duhet të bëjë komuna për të rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në punën e komunës?

Sqaroni: _____

20. A keni diçka të shtoni, që nuk ju kemi pyetur ? _____

Ju falemnderit për kohën tuaj dhe pjesëmarrjen !

PYETËSOR PËR FOKUS GRUPE ME PËRFAQËSUES TË VETËQEVERISJES LOKALE

Prezentim "Mirdita, quhem _____ dhe punoj për "Forumin e Gruas" shoqatë qytetare e cila merret me ngritjen e vetëdijes së grave, për pavarësimin e tyre, përforcimin e vetëbesimit dhe integrimin e grave në shoqëri.

Momentalisht realizojmë hulumtim për pjesëmarrje të qytetarëve me theks të veçantë të grave në proceset e sjelljes së vendimeve në komunat e rajonit të Tetovës (Tetovë, Jegunofcë, Tearcë, Bogovinë, Bërvenicë dhe Zhelinë). Ky hulumtim realizohet në korniza të grantit "Përmirësimi i zërit të qytetarëve, veçanërisht zëri i grave në proceset vendimmarrëse në nivel lokal" mbështetur nga Projekti i USAID-it për pjesëmarrje qytetare.

Ju falemnderit për pjesëmarrjen tuaj në këtë mbledhje e cila ka për qëllim të hulumtojë se në çfarë mënyre qytetarët marrin pjesë dhe kontribuojnë në sjelljen e vendimeve të komunës si dhe shërbimeve për të cilat ajo është përgjegjëse i përcjell.

A. Format e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve

1. A është ngritur nga komuna juaj aksion civil para Këshillit të komunës në 3 vitet e fundit (2016, 2017 dhe 2018)?
 - Kush është kryetar i Këshillit të komunës?
 - Cilat janë të dhënat e tij / të saj kontakt informatat?
 - Kush nga administrata e komunës është përgjegjës për punën e Këshillit (kontakt)?
2. A kanë bërë thirrje për mbledhje me qytetarët në tri vitet e fundit Këshilli i komunës ose Kryetari /ja ?
 - Nëse po, për cilat pyetje ?
 - Kush është përgjegjës nga administrata e komunës për organizimin e mbledhjes?
 - Ku ka qenë e vendosur ? publikuar informata për mbledhjen ?
3. A ka organizuar komuna, në tri vitet e fundit (2018,'17,'16) referendum?
 - Nëse po, për cilën pyetje ?
 - Kush është përgjegjës nga administrata e komunës për organizimin e referendumit?
 - Cilat janë kontaktet e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (Kryetar dhe Sekretar)?
 - Ku ka qenë e vendosur / publikuar informata për referendumin ?
4. Sa ankesa dhe sugjerime i kanë dorëzuar qytetarët në komunën tuaj në tre vitet e fundit?
 - A ka përcaktuar komuna shembull apo model për dorëzimin e propozimeve dhe ankesave?
 - Nëse po, a është shembull i apo modeli i botuar në gazetën zyrtare të komunës dhe / ose në web faqen e internetit të komunës?
 - A mund të na jepni numër të gazetës zyrtare apo link nga veb faqja e internetit?
5. A ka organizuar komuna në tri vitet e fundit tribina publike dhe / ose anketa ?
 - Nëse po, në cilat tema ?
 - Ku ka qenë e publikuar informata / ftesë?
 - Kush ka qenë /person përgjegjës nga ana e administratës së komunës?
- 6.Përkrahuesi mënyrën në të cilën komuna organizon debat publik dhe depërtim publik (inspektim publik) ?
 - Ku publikohet informacioni (shënoni adresën e sakt lokacionin /adresën /linkun, etj)?
 - Për cilat tema /dokumente organizohen debate publike dhe depërtim publik (inspektim publik) ?

7. A organizohet në komunën tuaj forum buxhetor?

- Ku i publikoni informacionet ?
- Kush është përgjegjës për thirrjen e pjesëmarrësve ?

B. Mekanizmat për pjesëmarrjen e qytetarëve

1. A ka Kryetari / ja ditë të pritjes ?

- Cilat janë ditë të pritjes ?
- Ku janë të publikuara ?
- A ka nevojë për paraqitje paraprake / lënë takim ?

2. A është caktuar person përgjegjës në komunë, i cili është përgjegjës për kordinimin dhe komunikimin me bashkësitë urbane dhe lokale?

- Nëse po, specifikoni kontaktet e e personit përgjegjës?
- A i ka komuna të publikuara kontaktet me kryetarët e bashkësive urbane dhe lokale ?
- Nëse po, tregoni se ku (numri i gazetës zyrtare dhe / ose lidhja në web faqen e internetit të komunës)?

3. A ka në komunën tuaj qendër për informimin e qytetarëve?

- Nëse po, kush është personi përgjegjës ?
- Specifikoni kontaktet e qendrës ?

4. Seancat e Këshillit të komunës janë publike. Ku i publikoni informatat për rendin e ditës për senacën?

- A duhet që qytetarët të njoftohen paraprakisht për të marrë pjesë?
- Nëse duhet, cili është person për kontakt (emri mbiemri kontakt telefoni / e-mail)?

C. Pjesëmarrje në publik për hartimin e dokumenteve të komunës

1. A ka komuna strategji zhvillimore / plan strategjik të komunës?

- A është përfshirë publiku në përgaditjen dhe në çfarë mënyre?
- Ku është e publikuar strategjia?

2. A ka qenë publiku i përfshirë në hartimin e programit vjetorë për punë?

- Në çfarë mënyre? Ku është publikuar dokumenti?

3. A ka qenë publiku i përfshirë në hartimin e buxhetit vjetor?

- Në çfarë mënyre? Ku është publikuar dokumenti?

4. A ka qenë i kyçur publiku në hartimin / rishikimin e planeve urbanistike?

- Në çfarë mënyre? Ku është publikuar dokumenti?

5. A ka qenë i kyçur publiku në hartimin e një plani ekologjik akcional lokal ?

- Në çfarë mënyre? Ku është publikuar dokumenti?

6. A ka qenë publiku i përfshirë në hartimin e planit akcional lokal për zhvillim ekonomik?

- Në çfarë mënyre? Ku është i publikuar dokumenti?

7. Tjetër (përshtkrui) _____

Ç. Komisionet e këshillit

1. A ka emëruar komuna koordinator për mundësi të barabarta ?
-Nëse po, specifikoni kontaktet?
2. A ka komuna të emëruar kordinator për bashkëpunim / komunikim me organizatat joqeveritare?
-Nëse po, specifikoni kontaktet?
3. Në korniza të komisionit të Këshillit të komunës a është në funksion komisioni për mundësi të barabarta për gra dhe burra ?
-Specifikoni kryetarin dhe anëtarët?
4. Në komunë, a është funksionale komisioni për marrëdhënie mes bashkësive?
-Nëse po, specifikoni kryetarin dhe anëtarët?
5. Në komunë, a funksionon këshilli për mbrojtje të konsumatorëve?
-Nëse po, specifikoni Kryetarin e këshillit ?

Ç.Informim i qytetarëve

Cilat nga mënyrat e mëposhtme përdoren për të vendosur informacion për qytetarët?

1. Folësi i komunës (zëdhënësi)
2. Tabela e buletinit të komunës
3. Inernet faqja e komunës
4. Gazeta zyrtare e komunës (detale për të njëjtin) Informatori i komunës (detale për të njëjtin)
5. Qendra për informim rë qytetarëve
6. Facebook profili i komunës (detale për të njëjtin)
7. Facebook profili i kryetarit / res (detale për të njëjtin)
8. Tjetër (përshkruani)

D.Perspektiva gjinore

- 1.A siguron përfqësim të barabartë të burrave dhe grave gjat organizimit të ngjarjeve? A ka dokument formal të shkruar?
- 2.Në cilën kohë të ditës organizohen mbledhjet e bashkësive lokale dhe urbane?
3. Dokumentet e komunës (strategjitë, programet, buxhetit, etj) a janë të rishikuara nga ana e komisionit për mundësi të barabarta ?

ECONOMIC ACHIEVEMENTS

CALL FOR CHANGE

EQUALITY

RESPECT

MARCH 8
GRATEFUL

SOCIAL AWARENESS
AUTONOMY

POLITICAL ACHIEVEMENTS

HISTORY

GENDER EQUAL

VOTE SUFFRAGE

EMPOWERMENT

LOVE
CELEBRATION
WOMEN
MOTHERS

INTERNATIONAL WOMEN'S DAY

SOCIAL ACHIEVEMENTS